L I G J
Nr. 8594, datë 6.4.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7564, DATË 19.5.1992 "PËR TË DREJTËN E AUTORIT"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.7564, datë 19.5.1992 "Për të drejtën e autorit" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 shkronja "a" ndryshohet si vijon:
"a) Vepra të shkruara, duke përfshirë edhe programe kompjuteri të shprehura në kod burimor ose në kod objekt."

Neni 2

Titulli i nenit 2 ndryshohet si vijon:
"Vepra të prejardhura dhe koleksione."

Neni 3

Titulli i nenit 18 ndryshohet si vijon:
"Kohëzgjatja e mbrojtjes së veprave anonime ose me pseudonim"

Neni 4

Në nenin 37, në pikën 3 shkronja "b", fjalët "… e nenit 39…" zëvendësohen me fjalët "… e nenit 38…"

Neni 5

Neni 50 ndryshohet si vijon:
"Përkthimi, përshtatja, regjistrimi viziv ose auditiv, importimi, riprodhimi dhe vënia në qarkullim, futja e aparaturave të posaçme për riprodhim zëri dhe figure, transmetimi në radio e televizion ose në çfarëdo sallë ose me çdo mjet tjetër të pronësisë artistike, pa lejen e autorit ose të shoqatës së cilës ia ka kaluar të drejtat, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji apo të marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, kur janë shkelur të drejtat morale dhe ekonomike të autorit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 vit.
Mosmarrëveshjet ndërmjet përdoruesit të veprës së pronësisë intelektuale dhe autorit ose shoqatës, të cilës i ka kaluar e drejta e tij, për mospërmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e lidhur ndërmjet tyre, i paraqiten gjykatës përkatëse nga pala e interesuar për shqyrtim civil."

Neni 6

Neni 51 ndryshohet si vijon:
"Dispozitat e këtij ligji u referohen:
a) veprave, autorët e të cilave janë me shtetësi shqiptare ose me banim të përhershëm në

Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nga vendi ku janë botuar për herë të parë;

b) veprave të botuara për herë të parë në Shqipëri ose në një shtet që është palë në marrëveshje ose në traktate ndërkombëtare për të drejtat e autorit, ku bën pjesë edhe Republika e Shqipërisë;

c) veprave të botuara për herë të parë në një shtet që nuk është palë në një marrëveshje ose në traktate ndërkombëtare për të drejtat e autorit, në të cilat merr pjesë Republika e Shqipërisë, në rastet kur këto vepra janë botuar njëkohësisht ose deri në 30 ditë diferencë në territorin e atij shteti dhe në Republikën e Shqipërisë ose në një vend tjetër anëtar në marrëveshjet ndërkombëtare, ku merr pjesë edhe Republika e Shqipërisë.

ç) veprave që janë krijuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që të mos t'u ketë kaluar afati i mbrojtjes që përmendet në këtë ligj."

Neni 7

Neni 52 ndryshohet si vijon:

"Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës të hartojnë aktet nënligjore përkatëse për zbatimin e këtij ligji."

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2601, datë 19.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.